

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektsh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Monitorues ne Qendren Tregtare Toptani

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Monitoruesi zbaton procedurat e vrojtimit elektronik te funksionimit te te gjitha sistemeve qe jane konfiguruar dhe perfshire ne BMS dhe raportimin ditor/periodik.

❖ DETYRAT KRYESORE

- Kryen procedurat e kontrollit, vrojtimit dhe raportimit ditor/periodik te funksionimit normal te te gjitha sistemeve qe jane konfiguruar ne softwarin (qe menaxhohen nepermjet BAS). Kontrollon ne menyre periodike funksionimin e paisjeve qendrore si UPS, gjeneratore, çillerat, pompat, etj;
- Kryen procedurat perkatese te njoftimit ne rast difekti/alarmi/avarie te sistemeve te instaluar ne Qender, te personeli perkates teknik te Departamentit Teknik;
- Sherben si qender kontakti per klientet e objekteve qe jane nen monitorim, ne rast difekti/alarmi/avarie te sistemeve te instaluar ne mjediset qe ata perkatesisht perdorin;
- Gjeneron raporte ditore/mujore qe sherbejne per sistemet e kontabilizimit te konsumit te energjise elektrike, HVAC, ujit, ne elementet e godines;
- Merr pjese ne procedurat per kualifikimin dhe trajnimin per te gjitha sistemet e instaluar me qellim per te rritur eficensen, cilesine dhe sigurine ne pune te impiantit;
- Kryen procedurat per komandimin e sistemeve nepermjet softwarit per funksionimin normal te tyre (paisjet perkatese te sistemit HVAC, etj) duke koordinuar punen me personelin inxhiniero-teknik te Sektorit;
- Kordinon me personelin teknik per identifikimin, llojin dhe zgjidhjen e dhene problemit, dhe raporton ne menyre te sakte problemin e ndodhur.

❖ KRITERET KRYESORE

- Të jetë i/e diplomuar ne arsimin e mesem profesional-dega elektronike/telekomunikacion/kompjuter;
- Të ketë specializime/certifikata të ndryshme në fushat e sistemeve dhe paisjeve elektronike;
- Mbi 3 vjet eksperiencë pune. Preferohet: Eksperiencë pune ne ndertimin, mirembajtjen/riparimin e sistemeve dhe paisjeve te ngjashme në kompani te tjera
- Anglisht, Italisht; njohuri ne nivel mesatar

Te gjitha te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 15 Prill 2022, ora 17:00**.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrotjen e të dhënave personale”.